

KËNAQËSIA E PUBLIKUT ME PUNËN E POLICISË

Nëntor 2024



Metodologjia

çështjet që mbulon pyetësoni

Siguria

- Siguria në lagje
- Siguria e shtëpive nga vjedhjet
- Siguria lidhur me të qenurit viktimë e një krimi të dhunshëm

Performanca në ndalimin e krimit

- Vlerësimi i punës së policisë
- Efektiviteti i policisë në parandalimin e krimeve të dhunshme
- Performanca e policisë në kapjen e hajdutëve të shtëpive
- Koha e reagimit të policisë për krimet e dhunshme

Gatishmëria e qytetarëve për bashkëpunim me policinë

- Gatishmëria e qytetarëve për të raportuar krimin
- Gatishmëria për të identifikuar të dyshuarit
- Gatishmëria për të ofruar prova në gjykatë

Ndërgjegjësimi për shkeljet e ligjit

- Mundësia e ndëshkimit për bërjen e një kërkese të rremë sigurimi
- Mundësia e ndëshkimit për blerjen e mallrave të vjedhura
- Mundësia e ndëshkimit për kryerjen e një shkeljeje rrugore

Drejtësia/paanshmëria e trajtimit nga policia e shtetit

- Trajtimi i grupeve shoqërore (të pasurve / të varfërve)
- Trajtimi i grupeve etnike
- Trajtimi me respekt nga policia
- Paanshmëria e policisë në vendime

Transparenca dhe përgjegjësia e Policisë së Shtetit

- Shpjegimi i vendimeve nga ana e policisë
- Perceptimi mbi ndikimin politik
- Perceptimi lidhur me rryshfetin

Vlerat dhe parimet e përbashkëta

- Mbështetja e publikut për veprimet e policisë
- Ndarja e të njëjtës ndjenjë të së drejtës dhe të gabuarës

Policimi në Komunitet

- Njohja me policimin në komunitet
- Ndikimi i policimit në komunitet në përmirësimin e jetës qytetare

Metodologjia

- Ky studim bazohet në 1,900 intervista të zhvilluara me të anketuar të moshës mbi 18 vjeç, të mbledhura nga e gjithë Shqipëria nëpërmjet kampionimit të kuotave.
- Pyetëtori përbëhet nga gjashtë seksione kryesore, secili i krijuar për të trajtuar aspekte të veçanta të objektivave të studimit.
- Anketa është përfaqësuese, pasi në përzgjedhjen e zonës është përdorur shtresëzimi sipas rajoneve dhe zonës së banimit (urban apo rural).
- Përzgjedhja e të anketuarve është e rastit dhe intervistat janë zhvilluar ballë për ballë me anë të tabletave.
- Të anketuarit janë përzgjedhur duke përdorur metodologjinë e ditëlindjes së fundit.
- Afati kohor i punës në terren:
6 tetor – 5 nëntor 2024
- Marzhi i gabimit, $\pm 2.2\%$ me 95% të nivelit të besimit.

Shpërndarja e intervistave

Qarku	Urban	Rural	Total
Berat	80	70	150
Dibër	40	110	150
Durrës	90	60	150
Elbasan	70	80	150
Fier	60	90	150
Gjirokastrë	60	90	150
Korçë	70	80	150
Kukës	50	100	150
Lezhë	40	110	150
Shkodër	60	90	150
Tiranë	180	70	250
Vlorë	90	60	150
Total	890	1,010	1,900

Kufizime të studimit

Ndikimi i lajmeve në perceptimin e qytetarëve

SHËNIM I RËNDËSISHËM



Lajmet dhe ngjarjet luajnë një rol të rëndësishëm në formësimin e perceptimeve të qytetarëve, veçanërisht për institucionet publike si Policia e Shtetit.



Në kontekstin e këtij raporti, që vlerëson nivelet e kënaqësisë së publikut me Policinë e Shtetit, është e rëndësishme të merret parasysh se si **ngjarjet e fundit dhe pasqyrimi i tyre në media mund të kenë ndikuar opinionin publik**, duke e ndryshuar atë.



Raportimet e marra nga intervistuesit tregojnë se shumica e të anketuarve e bazonin **vlerësimin e tyre për policinë në ngjarjet e fundit të pasqyruara gjerësisht në media**. Kjo sugjeron që ngjarjet që kanë ndodhur para ose gjatë fazës së mbledhjes së të dhënave kanë formësuar ndjeshëm perceptimet e qytetarëve. Ngjarjet që u pasqyruan në media kishin të bënin më së shumti me arrestimet e nisura nga SPAK. Incidentet që përfshijnë vrasje dhe raste dhune ndodhën pas përfundimit të mbledhjes së të dhënave, që do të thotë se rezultatet mund të mos pasqyrojnë këto ngjarje.



Duhet theksuar se, para dhe gjatë punës në terren, pati një **mbulim të gjerë mediatik për arrestimet dhe veprimet e zbatimit të ligjit të ndërmarra nga SPAK** (Struktura e Posaçme Antikorrupsion).

Këto veprime të ndërmarra nga SPAK, të cilat u diskutuan dhe u analizuan gjerësisht në media, ka të ngjarë të kenë ndikuar në perceptimet dhe vlerësimet e qytetarëve për performancën e policisë, pasi ishin ende të freskëta në mendjen e publikut.

Kufizime të studimit

Perceptimi dhe vlerësimi i ndikuar nga institucione të tjera

- Është e rëndësishme të theksohet se vlerësimi i publikut për Policinë e Shtetit (përgjegjëse për rendin dhe sigurinë publike) ndikohet shpesh nga perceptimet për institucione të tjera, si SPAK dhe Policia Rrugore. Ky vlerësim i ndërlidhur është i dukshëm gjatë mbledhjes së intervistave dhe konfirmohet edhe nga gjetjet e anketës.

Kryesisht vlerësimi bazohet te perceptimet

- Në përgjithësi, sipas të dhënave të anketës, shumica dërrmuese e qytetarëve e bazojnë vlerësimin e tyre mbi perceptimin që kanë për Policinë e Shtetit dhe jo mbi përvojën personale. Vlen të theksohet se ndër ata që kanë pasur kontakt me policinë, arsyeja më e zakonshme lidhet me Policinë Rrugore.



Refuzime për të marrë pjesë në anketë

- Gjatë mbledhjes së të dhënave, intervistuesit raportuan se qytetarët ishin përgjithësisht të hapur dhe të gatshëm për të shprehur mendimet e tyre mbi punën e policisë. Megjithatë, ata që ndjenin frikë ose hezitim nuk morën pjesë në anketë.
- Në këtë drejtim, është e rëndësishme të theksohet se qarqe të caktuara, si Elbasani, Shkodra, Lezha, Durrësi dhe Fieri, kishin përqindjet më të larta të refuzimit për të marrë pjesë në anketë, gjë që mund të shihet si një kufizim i studimit.

Përmbledhje e gjetjeve të studimit



Detyrat dhe përgjegjësitë e Policisë së Shtetit

Siguria:

- Rezulton se vetëm 4% e të anketuarve ose anëtarëve të familjes së tyre kanë qenë viktimë të një vjedhjeje ose sulmi fizik në 5 vitet e fundit, krahasuar me 6% në vitin 2020 dhe 2022.
- Për më tepër, 7% e të anketuarve raportuan se kishin qenë viktimë të incidenteve ose sulmeve gjatë 12 muajve të fundit, ku më të shpeshtat ishin aksidentet me makinë (35%), vjedhjet (27%) dhe mashtrimet (20%).
- Rezulton se 82% e të anketuarve deklaruan se ndihen të sigurt ose shumë të sigurt, gjë që nuk pasqyron ndonjë ndryshim domethënës midis rezultateve të studimit krahasuar me vitin 2020 (80%).
- Rreth 69% e të anketuarve treguan se ata kurrë nuk shqetësohen për vjedhjen e shtëpisë së tyre, duke sugjeruar një rritje graduale të ndjenjës së sigurisë krahasuar 2022 (62%).
- Rreth 78% e të anketuarve shprehin shqetësim të rastësishëm ose aspak për tu bërë viktimë të krimit të dhunshëm, duke reflektuar pothuajse të njëjtin nivel sigurie me vitin 2020 (75%).

Ndërgjegjësimi për shkeljen e ligjit:

- Në përputhje me valët e mëparshme të studimit, 92% e të anketuarve e konsiderojnë të gabuar bërjen e kërkesave të rreme të sigurimit, ndërsa 8% besojnë se është disi e gabuar ose aspak e gabuar.
- Përmirësimet janë të dukshme në opinionin e të anketuarve për blerjen e sendeve të vjedhura, ku 90% e të anketuarve e konsiderojnë këtë sjellje të gabuar, krahasuar me 83% në 2022.
- Pothuajse të gjithë të anketuarit (97%) besojnë se veprimet si tejkalimi i shpejtësisë ose kalimi me semafor të kuq janë të gabuara, duke reflektuar një pikëpamje të qëndrueshme për këtë çështje krahasuar edhe me 2022 (95%).



Ndërgjegjësimi për shkeljen e ligjit:

- Rreth 74% e të anketuarve besojnë se ka të ngjarë të kapen dhe të dënohen për bërjen e një kërkesë të rreme sigurimi, duke treguar rritje të ndërgjegjësimin për pasojat krahasuar me 2022 (61%).
- Vërehet e njëjta tendencë me anketat e kaluara ku 67% e të anketuarve e konsiderojnë të mundshme kapjen ose ndëshkimin për blerjen e mallrave të vjedhura, duke reflektuar një rritje të ndërgjegjësimin për pasojat, krahasuar me valët e kaluara (56% në 2020 dhe 53% në 2022).
- Perceptimi i të qenit i ndëshkuar për kryerjen e një shkeljeje rrugore, si shpejtësia ose kalimi me semafor të kuq, është përmirësuar në raport me anketat e kaluara, me 81% të të anketuarve në vitin 2024 që besojnë se ka të ngjarë të përballen me pasojat.

Ndërgjegjësimi për detyrat dhe përgjegjësitë e policisë:

- Pothuajse të gjithë të anketuarit (98%) besojnë se Policia e Shtetit duhet të merret me vjedhjet dhe shkeljet e të drejtave, ndërkohë që çështjet si zënia e trotuareve, ndërtimet pa leje dhe çështjet e taksave perceptohen të lidhura me policinë bashkiake, IKMT dhe Drejtorinë e Tatimeve, duke reflektuar përmirësimin e ndërgjegjësimin të publikut për rolet e institucioneve kundrejt rezultateve të mëparshme.

Vlerësimi i Policisë së Shtetit dhe trajtimi i saj ndaj grupeve të ndryshme shoqërore

Vlerësimet e performancës së policisë:

- Rreth 65% e të anketuarve e vlerësojnë punën e Policisë së Shtetit si "të mirë" ose "shumë të mirë". Kur shikohet në terma afatgjatë, vlerësimet e përgjithshme nuk tregojnë ndryshime të rëndësishme.

Kontakti me policinë:

- Rreth 92% e të anketuarve raportuan se nuk kanë pasur kontakte me policinë në dy vitet e fundit, ndërsa 7% pohuan se kanë pasur ndërveprim të drejtpërdrejtë. Gjirokastra ka përqindjen më të lartë të kontakteve të raportuara (25%), e ndjekur nga Durrësi dhe Elbasani (13%). Rreth një e treta e të anketuarve që kanë pasur ndërveprim të drejtpërdrejtë shprehen të kënaqur me trajtimin që kanë marrë nga policia.

Perceptimet lidhur me trajtimin e grupeve të shoqërisë:

- Gjysma e të anketuarve besojnë se policia i trajton individët e varfër më keq se të pasurit, ndërsa gjysma tjetër mendojnë se të dy grupet trajtohen në mënyrë të barabartë.

Efektiviteti në parandalimin dhe zgjidhjen e krimeve:

- Të anketuarit e vlerësuan efektivitetin e policisë në parandalimin e krimeve të dhunshme me 64/100 pikë. Në mënyrë të ngjashme, performanca e policisë në kapjen e hajdutëve të shtëpive mori 62 pikë, që tregon perceptime të qëndrueshme për efektivitetin në trajtimin e këtyre krimeve.



Reagimi i policisë:

- Të anketuarit vlerësuan kohën e reagimit të policisë për krimet e dhunshme ose vjedhjet pranë shtëpive të tyre me 65 pikë, duke mos treguar dallime domethënëse nga gjetjet e vitit 2022 (59 pikë). Vlerësimi më i lartë është regjistruar në qarkun Gjirokastrë (83 pikë), ndërsa më i ulëti në Shkodër (53 pikë).

Trajtimi me respekt nga policia:

- Rreth 67% e të anketuarve besojnë se policia "shumë shpesh" ose "shpesh" i trajton njerëzit me respekt, një rezultat i qëndrueshëm krahasuar me 2020 (65%) dhe në përmirësim krahasuar me 2022 (57%). Qarku Berat kryeson me 79% vlerësime pozitive, ndërsa Dibra (51%) dhe Durrësi (44%) raportojnë nivelet më të ulëta. Vetëm 5% besojnë se trajtimi me respekt nuk ndodh.

Paanshmëria e policisë:

- Në nivel kombëtar, 61% e të anketuarve mendojnë se policia shpesh merr vendime të drejta dhe të paanshme, një nivel që përputhet me rezultatet e vitit 2020 (60%) dhe në përmirësim krahasuar me 2022 (50%).

Shpjegimi i vendimeve të policisë:

- Gjysma e të anketuarve mendojnë se policia shpesh i shpjegon vendimet e saj kur pyetet, duke pasqyruar rezultatet e studimeve të mëparshme (53% në 2020 dhe 43% në 2022).

Vlerësimi i Policisë së Shtetit dhe trajtimi i saj ndaj grupeve të ndryshme shoqërore

Vlerat dhe parimet e përbashkëta:

- Gjysma e të anketuarve bien dakord se policia ndan të njëjtën ndjenjë të së drejtës dhe të gabuarës si ata. Po ashtu, 61% besojnë se policia mbron vlerat që janë të rëndësishme për ta, në përputhje me rezultatet e vitit 2022 (60%).

Mbështetja e publikut për veprimet e policisë:

- Rreth 62% e të anketuarve shprehin mbështetje për mënyrën se si vepron policia. Në një kontekst më të gjerë, ky nivel mbështetjeje ka mbetur relativisht i qëndrueshëm me kalimin e viteve (60% në 2020 dhe 58% në 2022).

Perceptimi mbi ndikimin politik:

- Gjysma e të anketuarve (50%) besojnë se vendimet e policisë ndikohen nga presioni politik, duke reflektuar një përmirësim të lehtë krahasuar me vitin 2022 (59%).

Perceptimi lidhur me ryshfetin:

- Në një shkallë nga 0-100, ku 0 do të thotë "kurrë nuk merr ryshfet" dhe 100 do të thotë "merr gjithmonë ryshfet", Policia e Shtetit mori një notë mesatare prej 53 pikësh, në përmirësim krahasuar me notën mesatare të marrë në 2022 (58 pikë).

Ndërgjegjësimi për "Policimin në Komunitet":

- Rreth 11% e të anketuarve janë në dijeni të "Policimit në Komunitet". Për ata që janë të vetëdijshëm, ai lidhet me bashkëpunimin e qytetarëve (50%) dhe promovimin e paqes, rendit dhe sigurisë (31%). Gjithashtu, 86% e këtyre të anketuarve e shohin "Policimin në Komunitet" pozitivisht, duke njohur ndikimin e tij të dobishëm.



Gatishmëria për të raportuar krimin:

- Dy të tretat (64%) e të anketuarve tregojnë se do të thërrisnin policinë nëse ishin dëshmitarë të një grabitjeje, duke reflektuar nivele të qëndrueshme të përgjegjësisë qytetare në krahasim me 2022 (59%).

Gatishmëria për të identifikuar të dyshuarit:

- Rreth 60% e të anketuarve shprehën gatishmërinë për të identifikuar një të dyshuar të përfshirë në një krim, duke treguar nivele të ngjashme angazhimi me 2020 (61%).

Gatishmëria për të ofruar prova në gjykatë:

- Gjysma e të anketuarve (51%) janë të gatshëm të dëshmojnë në gjykatë, duke reflektuar një gatishmëri të vazhdueshme për të marrë pjesë në procesin e drejtësisë me kalimin e kohës (49% në 2020 dhe 41% në 2022).

Ndikimi i ngjarjes së ndodhur gjatë punës në terren në rezultatet e studimit

Arrestimi i Z. Meta, ish-President i Shqipërisë, gjatë fazës së mbledhjes së të dhënave, nxjerr në pah rolin e rëndësishëm që luajnë ngjarjet e raportuara në media në formësimin e opinionit publik. Për ta shqyrtuar këtë, u krahasuan të dhënat para dhe pas ngjarjes për të kuptuar më mirë se si arrestimi ndikoi në perceptimet lidhur me performancën e policisë dhe treguesit e tjerë kryesorë.

Ndikimi në perceptimin e performancës së policisë:

- **Para arrestimit:** rreth 69% e të anketuarve vlerësuan policinë pozitivisht (punë shumë e mirë ose e mirë), me 4% e vlerësuan atë negativisht (punë e keqe ose shumë e keqe).
- **Pas arrestimit:** Vlerësimet pozitive ranë në 60%, ndërsa vlerësimet negative u rritën lehtë në 8%. Ky ndryshim sugjeron se ngjarja mund të ketë ndikuar besimin e qytetarëve për punën e policisë.



Ndikimi në transparencën e policisë:

- **Para arrestimit:** rreth 53% e të anketuarve besonin se policia "shpesh" ose "shumë shpesh" shpjegonte vendimet dhe veprimet e saj kur pyetej.
- **Pas arrestimit:** Kjo zbriti në 47%, duke reflektuar një rënie të lehtë të perceptimit të anketuarve për transparencën e policisë.

Mbështetja për veprimet e policisë:

- **Para arrestimit:** rreth 69% e të anketuarve shprehën mbështetje të përgjithshme për mënyrën se si vepron policia, ndërsa 68% besonin se policia mbron vlerave të rëndësishme për ta.
- **Pas arrestimit:** Mbështetja u ul në 56%, dhe ata që mendonin se policia ishte në përputhje me vlerat e tyre gjithashtu ra në 56%. Kjo rënie tregon një ulje të besimit të publikut pas arrestimit.


Rezultatet e studimit

1. Nivel kombëtar dhe krahasuar me valët e mëparshme dhe Evropën (ESS)
2. Nivel rajonal, urbanistik dhe gjinor
3. Rezultatet sipas kategorizimit Tiranë dhe rajone të tjera
4. Demografia e personave të anketuar



Siguria

Në 5 vitet e fundit, a keni qenë ju ose një anëtar i familjes suaj viktimë e ndonjë vjedhjeje (grabitjeje) apo sulmi (fizik)? (C5)




- Rezultatet e studimit për vitin 2024 tregojnë se vetëm 4% e të anketuarve ose anëtarëve të familjes së tyre kanë qenë viktimë të një vjedhjeje ose sulmi fizik në 5 vitet e fundit.
- Kjo paraqet një rënie të lehtë (brenda marzhit të gabimit) krahasuar me studimin e vitit 2022.
- Për më tepër, këto gjetje përputhen me rezultatet nga ESS Survey 2023, duke përforcuar më tej trendin pozitiv të vërejtur.

Siguria

Shqipëri vs Europë


Në 5 vitet e fundit, a keni qenë ju ose një anëtar i familjes suaj viktimë e ndonjë vjedhjeje (grabitjeje) apo sulmi (fizik)? (C5)



*Të dhëna nga ESS Survey, 2023

Siguria


- Gjatë 12 muajve të fundit, 94% e të anketuarve raportuan se nuk kishin qenë viktimë të ndonjë incidenti apo sulmi.
- Megjithatë, 7% treguan se kishin përjetuar të paktën një nga llojet e incidenteve të listuara në pyetësor.



7%
Kanë qenë viktimë


Po gjatë 12 MUAJVE TË FUNDIT, a keni qenë ju, viktimë e ndonjë...?(C+)

- Ndër ata që raportuan se ishin viktimë, llojet më të zakonshme të incidenteve ose sulmeve gjatë 12 muajve të fundit ishin aksidentet me makinë (35%), vjedhjet (27%) dhe mashtrimet (20%).



Siguria

Sa i sigurt ndiheni kur ecni vetëm në lagjen tuaj pasi është errësuar? C6)




- Të anketuarit u pyetën se sa të sigurt ndihen kur ecin vetëm në lagjen e tyre pas errësirës. Në vitin 2024, 82% e të anketuarve raportuan se ndiheshin të sigurt ose shumë të sigurt, që është pak më e lartë se në vitin 2022, ku përqindja e kombinuar ishte 78% (28% shumë të sigurt dhe 50% të sigurt).
- Krahasuar me vitin 2020, ku përqindja e kombinuar ishte 80% (29% shumë e sigurt dhe 51% e sigurt), nuk ka ndonjë ndryshim domethënës, duke reflektuar një perceptim relativisht të qëndrueshëm të sigurisë me kalimin e kohës.


Siguria

Shqipëri vs Europë


Sa i sigurt ndiheni kur ecni vetëm në lagjen tuaj pasi është errësuar? C6)



*Të dhëna nga ESS Survey, 2023



- Gati 69% e të anketuarve raportojnë se nuk shqetësohen kurrë për vjedhjen e shtëpisë së tyre, një përmirësim i dukshëm krahasuar me vitet e mëparshme.
- Në vitin 2022, 62% e të anketuarve treguan se ose herë pas here ose kurrë nuk ndiheshin të shqetësuar për vjedhjet, ndërsa në vitin 2020, shifra ishte 63%. Ky trend pozitiv sugjeron një ndjenjë në rritje të sigurisë midis pronarëve të shtëpive me kalimin e kohës.




- Përafërsisht 78% e të anketuarve raportojnë shqetësim të rastësishëm ose aspak për t'u bërë viktimë e krimit të dhunshëm, duke shënuar një përmirësim të dukshëm krahasuar me vitin 2022, kur vetëm 67% shprehën të njëjtin nivel sigurie.
- Megjithatë, rezultatet e vitit 2024 janë si ato të vitit 2020, ku 75% e qytetarëve treguan shqetësime të herëpashershme ose aspak shqetësim për të qënë viktimë e krimit të dhunshëm.

Ndërgjegjësimi për shkeljet e ligjit

Tregohen vetëm ato që janë përgjigjur “plotësisht gabim”


Sa gabim është të kryesh ndonjë nga veprimet e mëposhtme(D1-D3)



- Kur pjesëmarrësit u pyetën për pikëpamjet e tyre për shkeljet e ligjit, gati gjysma e të anketuarve shprehën mosmiratim të fortë për aktivitete të ndryshme të paligjshme. Konkretisht, 58% deklaruan se kryerja e një shkeljeje rrugore, si tejkalim shpejtësie ose kalim me semafor të kuq, është e gabuar.
- Për më tepër, 48% e pjesëmarrësve besonin se bërja e kërkesave të ekzagjeruara ose të rreme për dëmshpërblim nga siguracioni është gjithashtu e gabuar, ndërsa 43% mendonin se nuk ishte e drejtë të blinin sende që ata dyshonin se ishin vjedhur.
- Këto përgjigje pasqyrojnë një ndjenjë të qartë të standardeve etike dhe përgjegjësisë personale kur bëhet fjalë për çështjet ligjore.

Ndërgjegjësimi për shkeljet e ligjit


Sa gabim është të bësh një kërkesë të ekzagjeruar apo të rreme për dëmshpërblim nga siguracioni? (D1)



- Pyetja nëse është e gabuar të bësh një kërkesë të ekzagjeruar apo të rreme sigurimi u analizua më në detaje. Në mënyrë të ngjashme me gjetjet në vitin 2022 (92%), rezultatet e vitit 2024 tregojnë se një shumicë e fortë (92%) i konsideron veprime të tilla si të gabuara, me vetëm 8% që besojnë se janë disi të gabuara ose aspak të gabuara.
- Kjo paraqet një përmirësim të lehtë në krahasim me vitin 2020, kur 90% e të anketuarve kishin mendimin se bërja e kërkesave të rreme ose të ekzagjeruara të sigurimit është e gabuar, duke theksuar një konsensus të fortë dhe të vazhdueshëm kundër kësaj sjelljeje joetike.

Ndërgjegjësimi për shkeljet e ligjit


Sa gabim është të blesh diçka që ju mendoni se mund të jete vjedhur? (D2)



- Përmirësimet janë gjithashtu të dukshme kur shqyrtohet opinioni publik për çështjen e blerjes së sendeve që ata besojnë se janë të vjedhura.
- Në vitin 2024, 90% e të anketuarve e konsiderojnë këtë sjellje të gabuar, një rritje e dukshme nga 83% në vitin 2022 dhe 87% në sondazhin e vitit 2020. Ky trend rritës pasqyron një ndjenjë në rritje të përgjegjësisë personale dhe standardeve etike në lidhje me blerjen e mallrave të vjedhura.

Ndërgjegjësimi për shkeljet e ligjit

Sa gabim është të bësh një shkelje të rregullave të qarkullimit rrugor si tejkalim shpejtësie apo kalim me semafor të kuq? (D3)




- Një përmirësim i lehtë vihet re edhe kur analizohen opinionet se sa gabim është të bësh një shkelje të rregullave të qarkullimit rrugor si tejkalim shpejtësie apo kalim me semafor të kuq.
- Në vitin 2024, pothuajse të gjithë të anketuarit (97%) besojnë se këto veprime janë të gabuara; 95% në 2022 dhe 96% në 2020. Megjithëse rritja është modeste, ajo reflekton një konsensus të qëndrueshëm dhe të fortë kundër shkeljeve të trafikut gjatë viteve të fundit.

Ndërgjegjësimi për shkeljet e ligjit

Tregohen vetëm ato që janë përgjegjës “*ka shumë mundësi*”


Sa mundësi ka që ju mund të kapeni dhe të dënoheni nëse kryeni një nga veprimet e mëposhtme (D4-D6)



- Rezultatet tregojnë se vetëm 39% e të anketuarve besojnë se ka shumë mundësi të kapen dhe të penalizohen për kryerjen e një shkeljeje rrugore, të tillë si tejkalimi i shpejtësisë ose kalimi me semafor të kuq.
- Në mënyrë të ngjashme, vetëm 26% mendojnë se ka shumë të mundësi që ata të përballen me ndëshkim për bërjen e një kërkesë të rremë sigurimi, dhe vetëm 22% besojnë se do të mbeten përgjegjës për blerjen e sendeve të vjedhura.

Ndërgjegjësimi për shkeljet e ligjit


Sa mundësi ka që ju mund të kapeni dhe të dënoheni nëse bëni një kërkesë të ekzagjeruar/ekstreme apo të rreme për dëmshpërblim nga siguracioni? (D4)



- Një analizë më e thellë e deklaratave zbulon një përmirësim të lehtë në vitin 2024, me 74% të të anketuarve që besojnë se ka të ngjarë (ka shumë mundësi ose ka mundësi) që ata të kapen dhe të ndëshkohen nëse bëjnë një kërkesë të ekzagjeruar/ekstreme apo të rreme për dëmshpërblim nga siguracioni.
- Kjo shënon një rritje nga 61% në 2022 dhe 60% në 2020, duke treguar një ndërgjegjësim në rritje për pasojat e mundshme të veprimeve të tilla.

Ndërgjegjësimi për shkeljet e ligjit


Sa mundësi ka që ju mund të kapeni dhe të dënoheni nëse bleni diçka që ju mendoni se mund të jete vjedhur? (D5)



- E njëjta tendencë vërehet kur bëhet fjalë për gjasat për t'u kapur ose ndëshkuar për blerjen e mallrave të vjedhura.
- Në vitin 2024, 67% e të anketuarve besojnë se ka shumë mundësi ose ka mundësi që ata të kapen, krahasuar me 53% në 2022 dhe 56% në 2020. Kjo sugjeron një perceptim në rritje të rreziqeve që lidhen me blerjen e sendeve të vjedhura.

Ndërgjegjësimi për shkeljet e ligjit

Sa mundësi ka që ju mund të kapeni dhe të dënoheni nëse shkelni rregullat e qarkullimit rrugor si tejkalim shpejtësie apo kalim me semafor të kuq? (D6)




- Perceptimi për tu ndëshkuar për kryerjen e një kundërvajtjeje rrugore, si tejkalim shpejtësie ose kalim me semafor të kuq, është përmirësuar në krahasim me 2022 dhe 2020.
- Në vitin 2024, 81% e shqiptarëve besojnë se ka shumë mundësi ose ka mundësi që të përballen me pasoja për shkelje të tilla, nga 72% në 2022 dhe 68% në 2020. Kjo tregon një ndjenjë më të fortë llogaridhënieje dhe ndërgjegjësimi për dënimet e mundshme për shkeljet e trafikut.

Detyrat dhe përgjegjësitë e Policisë së Shtetit

A është detyra e Policisë së Shtetit të ndërhyjë në rastet e (PS1_a, PS1_b, PS1_c, PS1_d, PS1_e)


*Vetëm ata që janë përgjigjur “Po”



- Pothuajse të gjithë të anketuarit (98%) besojnë se është detyrë e Policisë së Shtetit të ndërhyjë në rastet e vjedhjeve apo shkeljeve të të drejtave të qytetarëve. Gjithashtu, një shumicë e konsiderueshme (89%) janë dakord që Policia e Shtetit duhet të adresojë shqetësimet për shkak të zhurmave nga klubet e natës. Rënia në përqindje e atyre që lidhin përgjegjësi të tjera me Policinë e Shtetit, si zaptimi i paligjshëm i trotuareve (65%), ndërtimet pa leje (64%) dhe çështjet që lidhen me taksat (54%) - reflekton rritjen e ndërgjegjësimin të publikut për rolet institucionale.
- Tashmë qytetarët i lidhin këto çështje me policinë bashkiake, IKMT dhe Drejtorinë e Tatimeve, duke treguar një kuptim më të qartë të ndarjes së përgjegjësisë.

Detyrat dhe përgjegjësitë e Policisë së Shtetit

Duke pasur parasysh të gjitha detyrat që Policia e Shtetit pritet të kryejë, do të thoni se ata janë duke bërë një punë të mirë apo një punë të keqe? (D7)




- Nuk e di
- Punë të keqe / shumë të keqe
- Punë as të mirë as të keqe
- Punë të mirë / shumë të mirë

- Në vitin 2024, 65% e të anketuarve besojnë se Policia e Shtetit po bën një punë të “mirë”/ “shumë të mirë”, krahasuar me 8% që mendojnë se po bën një punë të “keqe”/ “shumë të keq”.
- Krahasuar me studimin e vitit 2022, ka një rritje prej 6 pp në vlerësimet pozitive, duke u rritur nga 59% në 2022 në 65% në 2024. Vlerësimet negative u ulën me 3 pp, nga 11% në 2022 në 8% në 2024.

Detyrat dhe përgjegjësitë e Policisë së Shtetit

Në 2 vitet e fundit, a keni pasur kontakte me Policinë e Shtetit a ju ka ndaluar ose a ju ka kontaktuar për ndonjë arsye? (D8)




■ Nuk e di

■ Jo

■ Po


Atyre që kanë pasur kontakt u është kërkuar të përshkruajnë arsyen e kontaktit të tyre të fundit me policinë.



Detyrat dhe përgjegjësitë e Policisë së Shtetit

*vetëm ata që kanë pasur kontakt me policinë


Sa të kënaqur jeni ndjerë me mënyrën se si ju ka trajtuar Policia e Shtetit gjatë këtij kontakti? (D9)



- Përafërsisht një në tre të anketuar shprehin kënaqësi me mënyrën se si u trajtuan nga policia gjatë ndërveprimeve të tyre, duke reflektuar një rënie të lehtë nga viti 2022 (47%), kur gati gjysma e të anketuarve raportuan se ishin të kënaqur - të ngjashme me nivelet e vitit 2020 (42%).

Policia e Shtetit dhe trajtimi i grupeve sociale


Kur viktimat e ndonjë krimi raportojnë te Policia e Shtetit, a mendoni se Policia e Shtetit i trajton më keq të pasurit, më keq të varfrit, apo i trajton njëjloj si të pasurit ashtu edhe të varfrit? (D10)



- Kur u pyetën për drejtësinë e trajtimit të policisë ndaj individëve të varfër dhe të pasur, gjysma e të anketuarve besojnë se të varfërit trajtohen më keq (45%), ndërsa gjysma tjetër mendojnë se të dy grupet trajtohen në mënyrë të barabartë (47%).
- Megjithatë, ka pasur një përmirësim që nga viti 2022 (36% trajtim njësoj si i të pasurve ashtu edhe të varfërve), me një përqindje më të madhe njerëzish që tani besojnë se policia i trajton të pasurit dhe të varfërit në mënyrë të barabartë kur viktimat raportojnë një krim.

Policia e Shtetit dhe trajtimi i grupeve sociale

Kur viktimat e ndonjë krimi raportojnë te Policia e Shtetit, a mendoni se në përgjithësi Policia e Shtetit i trajton disa grupe njerëzish më keq për shkak të racës së tyre apo grupit etnik të cilit i përkasin, apo mendoni se çdokush trajtohet në mënyrë të barabartë? (D11)





- Nuk e di
- I trajton më keq njerëzit që i përkasin një race apo grupi etnik TË NJËJTË me shumicën e shqiptarëve
- Gjithkush trajtohet në mënyrë të barabartë pavarësisht nga raca apo grupi etnik
- I trajton më keq njerëzit që i përkasin një race apo grupi etnik NDRYSHE nga shumica e shqiptarëve

- Të anketuarit u pyetën gjithashtu nëse besojnë se policia i trajton individët ndryshe bazuar në racën ose përkatësinë e tyre etnike. Rezultatet tregojnë se 55% mendojnë se të gjithë trajtohen në mënyrë të barabartë, pavarësisht nga prejardhja e tyre, krahasuar me 46% në 2022, duke treguar një ndryshim pozitiv në perceptimin publik.



Reagimi i Policisë ndaj shkeljeve

Sa e suksesshme mendoni se është Policia e Shtetit në Shqipëri në parandalimin e krimeve ku është përdorur dhunë ose ka kërcënim për dhunë? (D12)





Reagimi i Policisë ndaj shkeljeve

Sa e suksesshme është Policia e Shtetit në kapjen e njerëzve që kryejnë vjedhje shtëpish në Shqipëri? (D13)




Reagimi i Policisë ndaj shkeljeve

Nëse do të ndodhte një krim i dhunshëm apo vjedhje shtëpie pranë vendit ku ju banoni dhe thërritet Policia e Shtetit, në mendimin tuaj, sa shpejt do të arrijë ajo në vendin e krimit? (D14)



Sjellja dhe veprimet e policisë


Bazuar në atë që ju keni dëgjuar apo përvojën tuaj, sa shpesh do të thoni se Policia e Shtetit i trajton njerëzit me respekt në Shqipëri? (D15)



- Gjashtëdhjetë e shtatë për qind e të anketuarve raportojnë se policia në Shqipëri i trajton njerëzit me respekt ose shumë shpesh ose shpesh, duke shënuar një përmirësim të ndjeshëm në krahasim me vitin 2022, kur vetëm 57% ndjenin të njëjtën gjë. Megjithatë, kjo shifër përputhet ngushtë me atë 65% të regjistruar në vitin 2020.

Sjellja dhe veprimet e policisë


Sa shpesh do të thoni se Policia e Shtetit merr vendime të drejta dhe të paanshme në rastet/ngjarjet me të cilat merren? (D16)



- Në përputhje me gjetjet e vitit 2020 nëse policia i trajton njerëzit me respekt në Shqipëri, 61% e të anketuarve besojnë se policia shumë shpesh ose shpesh merr vendime të drejta dhe të paanshme në rastet që trajton. Kjo përfaqëson një përmirësim nga viti 2022, kur vetëm 50% kishin të njëjtën pikëpamje dhe përputhet me shifrën 60% të vitit 2020.

Sjellja dhe veprimet e policisë



Në marrëdhënie me qytetarët/njerëzit, sa shpesh do të thoni se Policia e Shtetit në Shqipëri në përgjithësi i shpjegon vendimet dhe veprimet e saj kur kjo i kërkohet? (D17)



- Gjysma e të anketuarve besojnë se policia në Shqipëri i shpjegon vendimet dhe veprimet e saj shumë shpesh ose shpesh kur pyetet, një shifër pothuajse identike me rezultatet e 2020-ës (53%), por tregon një përmirësim të lehtë në krahasim me vitin 2022 (43%).


Ndërgjegjësimi dhe ndihma e qytetarëve ndaj policisë

Deri në çfarë mase mendoni se është detyra juaj qytetare për të mbështetur vendimet e marra nga Policia e Shtetit edhe kur ju nuk pajtoheni me to? (D18)




Ndërgjegjësimi dhe ndihma e qytetarëve ndaj policisë

Deri në çfarë mase mendoni se është detyra juaj qytetare për të bërë atë që ju thotë Policia e Shtetit edhe nëse ju nuk i kuptoni ose nuk pajtoheni me arsyet? (D19)




Vlerësimi mesatar (konvertuar në një shkallë nga 0 në 100)




Ndërgjegjësimi dhe ndihma e qytetarëve ndaj policisë

Deri në çfarë mase mendoni se është detyra juaj qytetare të bëni atë çfarë ju thotë Policia e Shtetit të bëni, edhe në qoftë se ju nuk e pëlqeni mënyrën se si ata ju trajtojnë? (D20)




Vlerësimi mesatar (konvertuar në një shkallë nga 0 në 100)



Ndërgjegjësimi dhe ndihma e qytetarëve ndaj policisë


“Në përgjithësi Policia e Shtetit ndan mendim të njëjtë për të drejtën dhe të gabuarën ashtu sikurse unë.” (D21)



- Gjysma e të anketuarve pajtohen me pohimin: *Policia në përgjithësi ka të njëjtën ndjenjë të së drejtës dhe të gabuarës si unë*, duke mos treguar asnjë ndryshim në krahasim me rezultatet e vitit 2022 (52%).

Ndërgjegjësimi dhe ndihma e qytetarëve ndaj policisë


“Policia e Shtetit mbështet parimet dhe vlerat që janë të rëndësishme për njerëz si unë” (D22)



- Gjashtëdhjetë e një për qind e qytetarëve besojnë se policia ruan vlerat që janë të rëndësishme për njerëz si ata, një shifër që mbetet e njëjtë si në vitin 2022.

Ndërgjegjësimi dhe ndihma e qytetarëve ndaj policisë


“Në përgjithësi unë e mbështes mënyrën se si Policia e Shtetit vepron zakonisht ” (D23)



- Gjashtëdhjetë e dy për qind e të anketuarve përgjithësisht mbështesin mënyrën e veprimit të policisë, duke shënuar një përmirësim të lehtë nga viti 2022, ku 58% shprehën të njëjtin mendim.

Ndërgjegjësimi dhe ndihma e qytetarëve ndaj policisë


“Vendimet dhe veprimet e Policisë së Shtetit janë të influencuara në mënyrë të padrejtë nga presionet e partive politike dhe politikanëve” (D24)



- Gjysma e të anketuarve (50%) mendojnë se vendimet dhe veprimet e policisë ndikohen në mënyrë të padrejtë nga presioni i partive politike dhe politikanëve. Kjo përfaqëson një rënie nga 59% që ishte në vitin 2022, duke sugjeruar një ndryshim në perceptimin publik në lidhje me pavarësinë e forcës policore.


Policimi në komunitet

Keni dëgjuar për "Policimin në Komunitet"? (PS2)



Policimi në komunitet



Çfarë ndikimi mendoni se do të këtë “Policimi në Komunitet” në përmirësimin e jetës së qytetarëve në zonën tuaj? (PS4)



- Policimi në komunitet vazhdon të shihet pozitivisht nga shumica e të anketuarve, me 86% që e shohin ndikimin e tij të dobishëm. Megjithatë, kjo shënon një rënie të lehtë nga viti 2022, kur 91% shprehën pikëpamje të ngjashme.
- Ndërsa shumica dërrmuese ende i pranon efektet pozitive të policimit në komunitet, ulja mund të tregojë shqetësimet fillestare ose ndryshimin e qëndrimeve që kërkojnë eksplorim të mëtejshëm.


Korrupsioni në polici

Sa shpesh do të thoni se Policia e Shtetit në Shqipëri pranon ose kërkon ryshfet? (D25)



Bashkëpunimi me policinë


Mendoni sikur patë që dikush shtyu një njeri në tokë dhe/ose i vodhi portofolin/çantën? Sa mundësi ka që ju në këtë rast të thërrisni Policinë e Shtetit? (D40)



- Dy nga tre të anketuar (64%) pohojnë se do të thërrisnin policinë nëse do të shihnin dikë që shtynte një burrë në tokë dhe ia vidhte portofolin. Kjo paraqet një përmirësim nga viti 2022, kur 59% e të anketuarve shprehën gatishmërinë për të ndërmarrë një veprim të tillë.
- Rritja sugjeron një ndjenjë në rritje të përgjegjësisë qytetare dhe besimit të policia, pasi më shumë njerëz tani janë të prirur të raportojnë aktivitetin kriminal.

Bashkëpunimi me policinë


Pa ja u kërkuar askush, sa i gatshëm do të ishit për të identifikuar personin që e kreu këtë shkelje? (D41)



- Gjashtëdhjetë përqind e të anketuarve thonë se do të ishin të gatshëm të identifikonin personin përgjegjës që kryen një vepër kriminale, si për shembull shtyrjen e dikujt në tokë dhe vjedhjen e portofolit të tyre.
- Kjo shënon një rritje të konsiderueshme nga viti 2022, kur gjysma e të anketuarve shprehën të njëjtin vullnet, duke treguar një ndjenjë në rritje të llogaridhënies dhe përgjegjësisë sociale.

Bashkëpunimi me policinë

Sa i gatshëm do të ishit për të dhënë dëshminë tuaj në gjykatë kundër të akuzuarve? (D42)



- Gjysma e të anketuarve (51%) shprehen gatishmërinë për të dhënë prova në gjykatë kundër një individi të akuzuar, duke reflektuar një rritje të dukshme nga viti 2022, kur 41% ishin të gatshëm ta bënin këtë. Kjo rritje sugjeron një besim në rritje në sistemin ligjor dhe një ndjenjë më të fortë të detyrës qytetare.